



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor

Nr. 51/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 12 / 2021

URDHËR

Nr. 69 datë 13.12.2021

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Në mbështetje të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 31.12.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, dhe Vendimit Nr/ 516, datë 01.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.03.2015 të këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2020-2023 dhe Pasaportës së Indikatorëve”

URDHËROJ

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor 2022-2024
2. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
ZEQIR ZEQAJ



Punoi: Ervis Reçi, Specialist
Data: 13/12/2021 - kopje 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

PLAN INTEGRITETI

2022-2024

Miruar me Urdhër të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr. __, datë __.__.2022

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Kryetar/Koordinator:

- Znj. Klotilda Kareçi

Anëtarë:

- Z. Femi Sufaj
- Z. Fatjon Kurti
- Znj. Avidana Pali
- Z. Arjan Koçiaj
- Z. Melsi Beli
- Znj. Blerta Doçi
- Znj. Drita Jaka
- Znj. Stefania Sotiri
- Znj. Alketa Sulo
- Z. Brikel Toma
- Znj. Alketa Kurpalaj
- Z. Aldo Meçi
- Z. Luan Aliaj

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të masës A.8.3 dhe A.9.2, të objektivit strategjik A.8 dhe A.9, të Planit të Veprimit 2020-2023 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratuar me VKM Nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar.

Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	4
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
HYRJE.....	6
PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT	7
QASJA METODOLOGJIKE	8
OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2022-2024.....	8
RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT.....	9
MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT	311
PLANI I INTEGRITETIT 2022-2024.....	322

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëadministrimin, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira karshi të dënuarve me dënim dhe të paraburgosurve në tërë sistemin penitenciar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka përgjegjësitë kryesore të menaxhimit financiar; menaxhimin e burimeve njerëzore; kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit, menaxhimin e sektorit të shëndetësisë, si edhe menaxhimin e kontrollin e sektorit të policisë së burgjeve, në kuadër të organizimit dhe funksionimit të sistemit penitenciar në Shqipëri.

Duke patur një rol qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin tonë, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe masat konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për individët në konflikt me ligjin, që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e kredibilitetin institucional.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka këto prioritete primare që vizionojnë veprimtarinë e saj:

- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit penitenciar
- Forcimi i procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit të të burgosurve
- Përmirësimi i shërbimit penitenciar profesional përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme
- Forcimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor të burgosurve, duke përfshirë edhe kujdesin e shëndetit mendor
- Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e burgjeve
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore të institucioneve penitenciare, nëpërmjet investimeve dhe pajisjeve logjistike

LISTA E SHKURTESAVE

MD	–	Ministria e Drejtësisë
SNKK	–	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit
GMS	–	Grupi i Menaxhimit Strategjik
DPB	-	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
SBNJ	-	Spektori i Burimeve Njerëzore
VKM	–	Vendim i Këshillit të Ministrave
NZ	-	Nëpunësi Zbatues
NA	-	Nëpunësi Autorizues
AB	-	Audit i Brendshëm
KLSH	–	Kontrolli i Lartë i Shtetit
IEVP	–	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
ABP	-	Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
DHAB	–	Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm
MVRI	-	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

HYRJE

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bazë të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ndjek dhe drejton organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit, ekzekutimit të vendimeve penale, në funksion të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Sistemi i burgjeve shqiptare ka trashëguar një histori komplekse për sa i përket parimeve që e kanë udhëhequr atë përgjatë dekadave të zhvillimit historik dhe politik të shoqërisë shqiptare. Vlerësimi i progresit të bërë në drejtim të reformës penitenciare, nxjerr në pah edhe risqet objektive me të cilat sistemi i burgjeve përballlet në përpjekje për ruajtjen të paprekshme të këtij sistemi vlerash. Megjithatë, përpjekjet për krijimin e një sistemi vlerash autentike për sistemin e burgjeve janë rritur në mënyrë progresive, duke rritur dhe fuqizuar brendësimin e vlerave të reja si transparenca, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia.

Misioni i DPB është të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të garantojë sigurinë, trajtimin human dhe kushtet e nevojshme për rehabilitimin social dhe ri-integrimin në shoqëri të shtetasve të paraburgosur dhe të dënuar. Përbushja e këtij misioni nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit, transparencës dhe respektit për dinjitetin njerëzor, siguron për shoqërinë një sistem penitenciar eficient.

Kuadri i përgjithshëm ligjor mbi bazën e të cilit funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve përfshin:

- Ligji 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"
- Ligji për Policinë e Burgjeve, 80/2020
- Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve
- Rregullore e Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve miratuar me urdhër Ministrit të Drejtësisë nr.5531/1, datë 05.09.2006
- Kodi i Etikës

Akte të tjera ligjore mbi bazën e të cilave funksionon DPB janë edhe:

- Kodi i Punës
- Ligji për statusin e Nënpunësit Civil nr.152/2013, i ndryshuar
- Kodi i Procedurave Administrative
- Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
- Ligji Nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

- Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- Ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe i gjithë kuadri tjetër ligjor që rregullon marrëdhëniet e menaxhimit financiar me sistemin e institucionit qendror në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji Nr.9154 dt.06.11.2003 “Per arkivat”
- Ligji Nr.8457 dt.11.02.199 “Per informacionin e klasifikuar “Sekret Shteteror” (i ndryshuar).

Miratimi i Planit të Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përfaqëson vullnetin institucional për fuqizimin e mëtejshëm të integritetit institucional, transparencës dhe parandalimin e korrupsionit në sistemin e burgjeve.

Ky dokument u hartua gjatë periudhës Shkurt – Nëntor 2021. Është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 334, datë 07.10.2021.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme,
- Vlerësimi i faktorëve të riskut
- Hartimi i masave të përshtatshme për adresimin e risqeve të evidentuara

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit. Këto fusha përfshijnë: menaxhimin financiar; menaxhimin e burimeve njerëzore; kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit.

Plani i Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve mbështetet dhe është në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Evropian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit, si dhe Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioriteteve kyçe të Komisionit Evropian.

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1. Ngritja e Grupit të punës me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1401, datë 10.02.2021 “Për ngritjen e grupit të punës së Integritetit”
2. Përgatitja e programit të punës për secilin anëtar të sektorit
3. Informimi i detajuar i punonjësve të institucionit mbi metodologjinë dhe aktivitetet e trajnimit të planifikuara për përgatitjen e planit të integritetit
4. Vlerësimi fillestar i integritetit në të gjithë sektorët përkatës të institucionit (fokus – grupe)

5. Mbledhja e informacionit të nevojshme nga çdo sektor
6. Shqyrtimi dhe analizimi i informacionit dhe i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin, ekspozimin dhe rezistencën e institucionit ndaj risqeve
7. Identifikimi dhe analizimi i faktorëve të riskut
8. Vlerësimi i risqeve të identifikuar
9. Hartimi i masave për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit
10. Priorizimi i masave zbatuese dhe rregullatore për minimizimin e risqeve
11. Përgatitja e regjistrit të riskut dhe planit të veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit
12. Përgatitja e raportit për gjendjen e integritetit në institucion
13. Shqyrtimi i planit të propozuar të integritetit
14. Miratimi i planit të integritetit

QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në përputhje me MVRI, u përdor:

Metoda cilësore, e cila u nda në disa etapa:

- Takime periodike me punonjësit e institucionit – fokus grupe, për të diskutuar risqet e secilës drejtori / fushës së mbikëqyrjes,
- Takime me përfaqësues teknikë nga Ministria e Drejtësisë dhe ekspertët e jashtëm,
- Analizë e kuadrit rregullator të brendshëm,
- Analizë e veprimitarisë së institucionit dhe e drejtorive përkatëse

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2022-2024

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vendosur pesë objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2022-2024, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë të Planit të Integritetit 2022-2024 janë:

1. Forcimi i procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit të të burgosurve
2. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit
3. Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies me publikun
4. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe fuqizimi i tyre përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme
5. Forcimi i integritetit në sistemin e prokurimeve
6. Administrimi financiar për përdorimin me efikasitet, kursim e dobishmëri të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikën e programit të burgjeve të shprehura në buxhetin e përcaktuar.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me

paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmblodhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi se:

1. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E AUDITIT TË BRENDSHËM

Spektori i Auditit të Brendshëm i jep siguri të arsyeshme titullarit të njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive si këshilla për përmirësimin e veprimtarisë, ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe procese të kontrollit të qeverisjes. Veprimtaria e Auditit të Brendshëm varet shumë nga niveli i maturimit të procesit të vlerësimit të riskut brenda njësisë publike.

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Spektori i Auditit të brendshëm i jep mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë.

Përgatit Planet Strategjike dhe vjetore për AB, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar.

Vlerëson:

- Përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit duke u fokusuar kryesisht në identifikimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike.
- Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike në kuadrin rregullator.
- Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi dhe efijencë.
- Përbushjen e detyrave duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.
- Përgatit Dosjet e Auditimit me të gjithë elementet shkresorë të përcaktuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, duke plotësuar deklaratën e pavarësisë dhe konfliktit të interesit.

Njësia e Auditit të Brendshëm njihet dhe ushtron veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të pranuar të Auditit të Brendshëm. Audituesit ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm.

Auditimet kryhen duke u udhëhequr nga interesi publik për të përforcuar besimin në ndershmëri, paanësi dhe efektivitet të shërbimit.

Punonjësi i sektorit të Auditit të Brendshëm nuk përfshihet në grupe pune pasi në veprimtarinë e tij nuk është strukturë zbatuese por kontrolluese.

Zbatimi i parimeve të Kodit të Etikës, monitorohet nga Përgjegjësi i Sektorit të auditit.

Për sa i përket mekanizmave të kontrollit, në kuadër të llogaridhënies ndaj strukturave eprore, ky sektor raporton te Drejtori i Përgjithshëm, dhe te Ministria e Financave, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Si i tillë, niveli i riskut të korrupsionit mund të konsiderohet i ulët duke qenë se sistemi ku operon Njësia e Auditit të Brendshëm është i kontrolluar dhe monitoruar nga struktura të tjera paralele (KLSH).

Nuk është identifikuar në të shkuarën asnjë rast korruptiv nga nëpunësit e këtij sektori.

II. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të riskut që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit të Auditit të Brendshëm, si dhe impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund të konsiderojmë:

Operacionalë

Sektori i Auditit të Brendshëm mbikqyr proceset duke marrë në konsideratë edhe funksionimin e sinjalizuesit që është atashuar pranë kësaj drejtorie.

- Kapacitete teknike të kufizuara në garantimin e kontrolleve të brendshëm. Kjo sa lidhet me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, të tilla si programet etj..
- Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e Auditit të brendshëm. Akulisht ky sektor numëron 2 vende vakante¹.

Operacional + Përputhshmërie

- Mungesë në njohjen dhe zbatimin e ligjit Nr.60/2016 “Për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve” dhe procedurave të sinjalizimit².
- Mungesë e rregullave të detajuara për procedurën e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe praktikave të dyshuara korruptive nga ana e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
- Mungesa në njohjen dhe zbatimin e ligjit Nr.60/2016 “Për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve” dhe procedurave të sinjalizimit është me risk të mesëm në veprimtarinë e Institucionit.

2. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E FINANCËS / BUXHETIT:

Në zbatim të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023 dhe në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me urdhrin Nr. 334, datë 07.10.2020, është hartuar raporti i vlerësimit të riskut të integritetit për Sektorin e Financës / Buxhetit.

¹ Në cilësinë e audituesit

² Këto procedura ekzekutohen përmes Njesisë së Sinjalizimit, e cila është atashuar pranë Sektorit të Auditimit të Brendshëm, përgjegjëse për regjistrimin, hetimin administrativ dhe shqyrtimin e sinjalizimeve për veprime ose praktika të dyshuara korruptive.

Sektori i Financës ka për mision të mbështesë punën e sektorëve funksionalë nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të punës së financës duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet burimet financiare për të përmbushur misionin parësor të gjithë Sistemit të Burgjeve dhe objektivat e përgjithshme të tij.

Realizimi i këtij misioni synon të japë siguri objektive për vijimësinë e një aktiviteti normal të sistemit, duke përmbushur njëkohësisht nevojat për investime në ndërtime e pajisje, infrastrukturë zyre dhe shpenzime të tjera operative në të gjithë sistemin e burgjeve.

Ky harmonizim plotësohet me monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të fondeve buxhetore nga staf punonjësish të rekrutuar me kujdes dhe një dokumentim e ruajtje të sigurtë të korrespondencave, që realizohen brenda këtij sektori.

Realizimi i tre objektiveve themelore të sistemit të burgjeve mbështetet edhe nga kontributet e punës së financës, nëpërmjet arritjes së objektiveve specifike të mëposhtëm:

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Administrimi financiar për përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të burgjeve të shprehura në buxhetin vjetor të miratuar.

Përshkrimi i nën/proçeseve:

- Hartimi i programit Buxhetor Afat mesëm (PBA)
- Hartimi i Bilancit vjetor për D.P.Burgjeve dhe sistemin e burgjeve
- Procedurat e kryerjes së pagesave, regjistrimit dhe kontabilizimit të tyre
- Procedurat e administrimit/dokumentimit të vlerave monetare të institucionit
- Procedurat e administrimit/ dokumentimit të vlerave materiale të institucionit
- Mbajtja dhe administrimi i të dhënave mbi llogaritë kontabël gjatë vitit ushtrimor
- Kryerja e pagesave të pagave, dietave, sigurimeve dhe tatimeve çdo muaj
- Raportimet mujore mbi ecurinë e fondeve buxhetore për sistemin e burgjeve
- Detyra të tjera të lindura gjatë aktivitetit normal të sektorit

II. Strukturat e përfshira:

Sektori Financë / Buxhet

Mbështetës: Nëpunës Zbatues si dhe të gjithë sektorët e tjerë në DPB³

III. Kuadri ligjor:

- Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
- Ligji Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" si dhe i gjithë kuadri tjetër ligjor që rregullon marrëdhëniet e menaxhimit financiar me sistemin e institucionit qendror në Republikën e Shqipërisë.

IV. Vlerësimi i faktorëve të riskut

³ sipas specifikës

Financat publike efektive janë një mjet i rëndësishëm për vendosjen e prioriteteve institucionale ekonomike dhe sociale brenda burimeve në dispozicion të institucionit⁴.

Në të kundërt, menaxhimi joefikas ose joadekuat i financave publike mund të rezultojë në humbje financiare, ulje të investimeve totale dhe ulje e infrastrukturës, performancë e dobët e institucioneve.

Faktorët e riskut të identifikuar sa lidhet me buxhetin dhe menaxhimin financiar janë si më poshtë⁵:

- Planifikimi jo i mirë: Përpyqja e dështuar për të ndërlidhur politikën, planifikimin dhe buxhetimin mund të kontribuojë në rezultate të dobëta buxhetore.
- Paaftësia për të parashikuar në mënyrë realiste mund të çojë në mungesë transparence gjatë ekzekutimit të buxhetit.
- Financimi i pamjaftueshëm i nevojave për mallra dhe mirëmbajta mund të rezultojnë në performancë të ulët të sistemeve.
- Mungesa e lidhjes ndërmjet buxhetit të parashikuar dhe atij të ekzekutuar. Menaxhimi joadekuat i llogarive krijon mundësi për devijimin e fondeve publike në llogari private.

V. Risqet e Integritetit

- Menaxhimi i i raportimeve financiare jo në kohë dhe joefikase mund të rezultojnë në mundësi për rreziqe të veprimeve financiare (krijimi detyrimeve, krijimi i moslikuiditetit për shërbime të ndryshme)
- Përgatitja e Projekt – buxhetit afatmesen dhe afatgjate jo efikas krijon veshitësi të shumta për mosrealizimin e funksionit dhe qëllimeve të njëjësive shpenzuese në aktivitetin e tyre
- Ndarja e buxhetit jo në përputhje të plotë të kërkesave reale con në mos realizimin e nevojave jetike të njëjësive shpenzuese që ka sistemi i burgjeve
- Zyrtarët mund bëjnë modifikime të paautorizuara në bazën e të dhënave të listës së pagave për përfitime personale. Zyrtarët mund deklarojnë detaje të pasakta të dhënash në përpunimin e listës së pagave. Si rezultat, pagat mund t’iu paguhen punonjësve fiktivisht.
- Zyrtarët mund të japin informacion të rremë për rimbursimin e shpenzimeve, të bëjnë kërkesa për rimbursim bazuar në fatura të pavërteta. Verifikimi jo i duhur i faturave çon në tepriçë pagesash.

VI. Strategjitë potenciale për menaxhimin e riskut:

- Të sigurohet informacion në mënyrë sistematike para titullarit të institucionit. Parashtron për njohje dhe vlerësim të gjitha dokumentet kontabël dhe financiar të nevojshëm për një miratim korrekt mbi buxhetin.
- Në vijim të rregulloreve të institucionit, të prezantohet dhe të zbatohet një rregullator operacional i qartë dhe gjithëpërfshirës nën kornizën e menaxhimit buxhetor dhe atij fiskal. Mekanizmat për buxhetimin dhe formulimin e politikave duhet të jenë në mënyrë eksplicite, projektuar për të përforcuar koordinimin dhe kohezionin në vendimmarrje.
- Të planifikohet buxheti duke u bazuar në informacione të besueshme.
- Të planifikohet prokurimi i rakorduar me zërat buxhetorë të parashikuar.

⁴ si njësi shpenzuese

⁵ Listë jo shteruese

- Të trajnohet i gjithë personeli përkatës në kuadër të fuqizimit të tyre si asetë
- Ndërtimi i kapaciteteve për pjesëmarrje efektive të të gjithë stafit përkatës në procesin buxhetor në të gjitha fazat e tij.
- Vëmendje e shtuar në drejtim të sigurimit të kapaciteteve adekuate të drejtuesve të njësive të cilat duhet të hartojnë buxhetet e tyre të parashikuara.
- Përmes të gjitha fazave të procesit buxhetor (formulimi, miratimi, zbatimi dhe vlerësimi), institucionit t'i ofrohet në kohë informacion i plotë, transparent dhe gjithëpërfshirës mbi aktivitetin fiskal të kaluar, aktual dhe të parashikuar, duke specifikuar objektivat e politikës fiskale, kuadrin makroekonomik, bazën e politikave për buxhetin dhe rreziqet kryesore fiskale të identifikueshme.
- Të sigurohet që të dhënat e buxhetit të jenë të klasifikuara dhe të paraqitura në një mënyrë miqësore dhe të thjeshtë gjë e cila të mundësojë analizën e politikave dhe promovimin e llogaridhënies.
- Të sigurohet pjesëmarrja (përfshirja) e punonjësve në formulimin e programit të shpenzimeve.
- Të raportohet në kohë. Raportimi të jetë gjithëpërfshirës, i besueshëm, dhe të identifikojë devijimet nga buxheti. Dokumentat e financave publike duhet të mbulojnë buxhetet, raportet brenda vitit, raportet e mesit të vitit, raportet e fundvitit dhe raportet e auditimit.
- Të sigurohet disponueshmëria dhe zbatimi i procedurave të specifikuara qartë dhe gjithëpërfshirëse për ekzekutimin dhe monitorimin e shpenzimeve të miratuara.
- Të vërtetohen faturat me dokumentacion mbështetës si p.sh kërkesa dhe urdhra blerjeje për të ndihmuar të sigurohet që të gjitha pagesat janë për mallra dhe shërbime të ligjshme.
- Të sigurohet rakordimi i rregullt dhe i saktë i të gjitha transaksioneve.

3. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E PROKURIMEVE

Spektori i Prokurimeve si detyrë funksionale ka si qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të IEVP-ve dhe të të burgosurve duke u bazuar në ligjin Nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, datë 23.12.2020 dhe VKM 285, datë 19.05.2021, Rregullores së Brendshme, si dhe përdor të gjithë legjislacionin material dhe procedural në fuqi, në mënyrë që aktet e nxjerra si produkt i veprimtarisë dhe punës së këtij sektori në permbushjen e këtij qëllimi të jenë sa më të vlefshme.

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Spektori Prokurimeve Publike mbron interesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve duke mbajtur në konsideratë:

- a) Rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik;
- b) Mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale;
- c) Nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- d) Nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- e) Ofrimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- f) Të operuarit me integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Spektori i Prokurimeve Publike,

- Ndjek procedurat e prokurimit dhe kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të ankesave të operatorëve ekonomikë të mbërritura në Sektor, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në atë ligjor, duke bashkëpunuar edhe me strukturat e tjera në institucion.
- Siguron realizimin në kohë të procedurave për prokurimin e fondeve sipas buxhetit të miratuar.
- Përgatit përgjigjet për kërkesat e operatorëve ekonomikë, duke u konsultuar paraprakisht me strukturat e tjera në institucion që janë përgjegjëse për rastet konkrete, dhe i diskuton ato me strukturat eprorë.
- Përgatit materialet shpresore të nevojshme dhe të gjitha aktet e tjera proceduriale drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, Ministrisë së Drejtësisë etj..
- Mban kontakte dhe bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë sektorit apo institucionit, si dhe me institucionet e varësisë, për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që lidhen me procedurat e prokurimeve.
- Merr pjesë në grupe pune, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari si pjesë e Njësisë së Prokurimit, asistencë ndaj Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave etj..
- Siguron të dhënat e nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatit regjistrin e parashikimit dhe regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit publik;

Zbatimi i parimeve të Kodit të Etikës dhe në çënim të figurës së punonjësit, përveçse nga Drejtori i Drejtorisë, monitorohen edhe nga sektori i burimeve njerëzore.

Si i tillë, niveli i riskut të korrupsionit mund të konsiderohet i lartë pasi Sektori i Prokurimeve ka procese që mund të jenë të ekspozuara direkt ndaj korrupsionit.

II. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, pranë sektorit të Prokurimeve Publike, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

Reputacional

- a) Konflikti i interesit i nëpunësve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, parashikuar në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005.
- b) Trajtim jo i barabartë dhe diskriminues ndaj operatorëve ekonomikë, me operacione jo transparente e në mënyrë jo proporcionale, ku një kontribut tejet të rëndësishëm në këtë detyrë luan sektori i prokurimeve.
- c) Kriteret e vendosur nga pjesëtarët e grupeve të punës të përgatitjes së specifikimeve teknike, kriterëve kualifikues dhe prokurimi në tërësi mund të përgatiten me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Operacional /procedural

- a) Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e procedurave të prokurimit publik
- b) Konfuzion rolesh për shkak të vakancave
- c) Ngarkesë e lartë që ka risk të përkthehet në vonesa proceduriale.

Financiar

- a) Zbatimi jo me efikasitet i ligjit të prokurimit publik, dhe mungesa e nxitjes dhe inkurajimi i operatorëve ekonomikë shkakton një keqpërdorim të fondeve publike duke krijuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

4. VLERËSIMIT I RISKUT TË INTEGRITETIT NË KUADËR TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

I. Kuadri Ligjor

Në zbatim të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023 dhe në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me urdhrin Nr. 334, datë 07.10.2020, është hartuar raporti i vlerësimit të riskut të integritetit sa lidhte me strukturën e Koordinatorit për të drejtën e informimit.

E drejta për informim është e drejta e çdo qytetari për t’u njohur me informacionin publik e garantuar ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr.119/2014 për të drejtën e informimit i cili synon nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Transparenca përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët, me qëllim pasjen e një qeverisje lokale të mirë dhe demokratike. Ajo nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së Institucioneve në mënyrë të hapur me publikun.

Aksesi i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në parandalimin e korrupsionit, dhe si i tillë institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët.

II. Analiza e organizimit të brendshëm.

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik cakton një prej nëpunësve si Koordinator për të drejtën e informimit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit.

Ky koordinator ekzekuton funksionin e tij bazuar në ligjin e sipërcituar si dhe Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008 Për mbrojtjen e të dhënave personale.

III. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Koordinatorin për të drejtën e informimit i Autoritetit Publik ushtron kompetencat e mëposhtme:

- I mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- Krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji;
- Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj;
- Regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;

- Dërgon kërkesën për informim te një Autoritet tjetër Publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se Autoriteti Publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar;
- Verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13 të këtij ligji;
- Kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikon me kërkuuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

IV. Analiza e procesit të zinxhirit vendimarrës

Me qëllim zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit çdo autoritet publik cakton një koordinator për të drejtën e informimit. Ky është një detyrim ligjor, me qëllim lehtësimin e procesit të marrjes së informacionit, edhe pse nuk mjafton thjesht caktimi, por mbi të gjitha fuqizimi i rolit të tij dhe rritja e përgjegjshmërisë.

Zbatimi i parimeve të Kodit të Etikës dhe në çënim të figurës së punonjësit, monitorohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

Niveli i riskut të korrupsionit mund të konsiderohet i ulët pasi Koordinatori nuk ka proçese dhe struktura potenciale apo të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit.

V. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e së drejtës për t'u informuar, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund të konsiderojmë:

Reputacional

1. Publicitet negativ në media:

E drejta për një shtyp të lirë është një e drejtë Kushtetuese në shumë vende dhe drejtuesit e lartë të shteteve⁶ nuk mund të aprovojnë ligje të cilat kufizojnë lirinë dhe të drejtën për të marrë informacion. Por liria e medias tejkalohet në rastet kur publikohen informacione të pavërteta.⁷ Koordinatori duhet të jetë sa më korrekt dhe serioz dhe të bëjë një përfaqësim sa më dinjitoz të Institucionit.

2. Bërja publike dhe çënimi i të dhënave personale të çdo të dënuari.

Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore. Çdo individ duke përfshirë dhe ata të cilët gjenden në një institucion të vuajtjes së dënimit ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Në ligjin nr 81/2020 "Për të Drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në nenin 84 përcaktohet Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit ku përcaktohet mënyra si ruhen dhe përpunohen të dhënat personale. Në pikën 3 përcaktohet se "Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në njoftimet publike duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdiskriminimit, etikën profesionale dhe dinjitetin e personave të

⁶ Presidentë dhe Kryeministra

⁷ në raste kur personat publikojnë këto informacione me vetëdije dhe pa i verifikuar, ndaj tyre duhet të merren masa dhe të paditen

burgosur, veçanërisht të të miturve. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në nenin 18 përcaktohet – “Mbrojtja e të dhënave personale” dhe në Nenin 19 “Përdorimi i të dhënave personale”. Në nenin 19 pika 4 përcaktohet se i paraburgosuri apo i dënuari ose një person i autorizuar prej tij, mund t’i kërkojë drejtorit të IEVP-së të njihet me të dhënat personale të tij, pasi i deklaron drejtorit shkakun dhe llojin e informacionit që i duhet. Drejtori i IEVP-së duhet të sigurohet që informacioni i dhënë nuk lidhet me një të paraburgosur apo të dënuar tjetër. Në pikën 5 të po këtij neni përcaktohet se në rast se informacioni kërkohet nga një person i tretë, për dhënien e tij duhet marrë më parë pëlqimi me shkrim i të paraburgosurit apo të dënuarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kur informacioni i jepet palëve të treta ose përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të të dënuarve bëhet jashtë dispozitave të përcaktuara nga Ligjet dhe Rregulloret në fuqi zbatohen masat administrative.

3. Humbje e besimit

Në opinionin publik: Informacionet e ndryshme që përcillen të cilat mund të jenë shpesh të pavërteta mund të ndikojnë në besimin dhe perceptimin që ka opinioni për punën dhe rezultatet e Autoritetit Publik.

5. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE

I. Kuadri Ligjor

Spektori Burimeve Njerëzore për shkak të natyrës së punës së tij, duke qenë se detyrat funksionale lidhen me procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit nëpërmjet një procesi transparent, identifikimin e nevojave për rritjen profesionale të stafit, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës në institucion, me qëllim krijimin e vlerave të qëndrueshme, drejtimin strategjik të politikave dhe planeve, si dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave, që të mund të realizohet misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Spektori i Burimeve Njerëzore organizon dhe rregullon veprimtarinë e saj duke u mbështetur në akte rregullative si:

1. Ligji për Policinë e Burgjeve, 80/2020
2. Kodi i Etikës
3. Urdhëri Nr. 3125/1, datë 04.09.2009 “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhien e punës, trajnimit, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e Policisë së Burgjeve’
4. Urdhri Nr. 5251/2, datë 30.07.2010 “Për miratimin e rregullores ‘Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve’
5. Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve
6. Rregullore e Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve miratuar me urdhër Ministrit të Drejtësisë nr.5531/1, datë 05.09.2006
7. Urdhër Ministri i Drejtësisë nr. 6783, datë 17.11.2018 për përcaktimin e “Kritereve të posaçme për pozicionet e punës në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”.
8. Urdhri Nr. 7375, datë 24.11.2015 “Mbi procedurën e pranimit të kandidatëve për punonjës në Policinë e Burgjeve”
9. Ligji për statusin e Nënpunësit Civil nr.152/2013, i ndryshuar
10. Kodi i Punës
11. Kodi i Procedurave Administrative

12. Ligji Nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
13. Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
14. Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
15. Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",

II. **Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë**

- Drejton procesin e procedurave të punësimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e varësisë, suke siguruar një proces objektiv, transparent dhe të hapur.
- Mbështet fuqishëm procesin e ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, nxit përkushtimin e stafit në kryerjen e detyrave funksionale.
- Zbaton aktivitetet e kontrollit, monitoron përshtatshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e funksionimit të kontroleve të brendshme, si dhe inicion përmirësimit në aktivitetin e kontrollit.
- Mban dokumentacionin për kontrollet, garanton plotësimin e dosjes teknike të stafit, rifreskimin dhe pasurimin e tyre për punonjësit e sistemit të burgjeve, si dhe paraqet pranë sektorit të financës kohën e vjetërsisë në punë të punonjësve për pagesën e tyre konform rregullave.
- Zhvillon një sistem për raportimin e brendshëm, mban një sistem efektiv komunikimi dhe informimi.
- Ndjek plotësimin e librezave të punës dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve të pozicionit të punës së stafit.
- Ndjek dhe perpilon praktikën e pensioneve për ish ushtarakët në ligjit zbatim të Ligjit Nr.10142 datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Siguron, përgatitjen dhe administrimin e vlerësimeve vjetore të stafit, si dhe asiston dhe bashkëpunon me drejtorët e drejtorive për realizimin e vlerësimeve individuale, konfirmimin e nëpunësve dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit.
- Ndjek procesin e procedurave disiplinore për stafit, si dhe përgatit udhurat e emërimit, lirim, kontratave të punës, si dhe kryerjen e lejeve vjetore të stafit.
- Harton dhe ndjek praktikën e standardizuar të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë sistemin e burgjeve, si dhe sipas rastit, moniton zbatueshmërinë e urdhrave të titullarëve.
- Kryen kontrollin e njësive të burimeve njerëzore në institucionet e varësisë, si dhe këshillon titullarët.
- Ndjek dhe koordinon punën për përfundimin e praktikave dokumentare, si dhe udhëheq procesin e ristrukturimit dhe reformimit të strukturave të burimeve njerëzore për përmirësimin e zbatimit të politikave të burimeve njerëzore.

- Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të specialistëve të sektorit, duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë, duke diskutuar ecurinë dhe duke theksuar fushat në të cilat janë të nevojshme të bëhen përmirësime.
- Siguron ndjekjen e respektimit të orarit të punës, disiplinës dhe etikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
- Mban kontakte me qytetarë të interesuar për tërheqjen e dokumentacioneve, si dhe ofron asistencën e nevojshme.
- Mban kontakte me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe dokumentacione të ndryshme.

III. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit burimeve njerëzore, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

Operacional /proceduralë

- i. Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e rëndësishme në stafin civil por dhe atë me uniformë rreth 400 vakanca në sistem të cilat natyrisht duhet proceduar sipas parashikimeve ligjore në plotësimin e tyre duke ndikuar kështu edhe në rritjen e performancës së punonjësve dhe evitimin e çdo elementi abuziv.

Financiar

- ii. Shpenzime të larta si pasojë e pagesës së dietave për shkak transferimi apo komandimi në institucione të parashikuara në aktet ligjore, konkretisht vkm nr.920 datë 25.11.2020 parashikon kushtet dhe kriteret lidhur me përfitimin e pagesave nga punonjësit.

6. VLERËSIMIT I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN SOCIAL

I. Struktura e organizimit të brendshëm të sektorit

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 43, datë 25.03.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sistemit të institucioneve në varësi të saj”, ky sektor u emërtua Sektor i Shërbimit Social me 4 specialistë dhe një përgjegjës sektori në strukturë, në varësi të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Shoqërore e cila është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Struktura organizative e Sektorit të Shërbimit Social ndër vite nuk ka pësuar ndryshime dhe ka qenë e qëndrueshme e pa vende vakante.

Stafi përgjithësisht ka qenë i qëndrueshëm, i përbërë më së shumti nga specialistë me përvojë disa vjeçare në sistemin e burgjeve, duke siguruar kështu qëndrueshmëri në ndjekjen dhe vazhdimësinë e proceseve të punës të këtij sektori.

Po ashtu, specialistët e emëruar rishtaz kanë sjellë njohuri bashkëkohore akademike, të cilat të alternuara me përvojën disa vjeçare të kolegëve të tjerë kanë pasuruar metodologjinë e punës në sektor.

Punonjësit e këtij sektori janë nëpunës civil, të cilët rekrutohen sipas një procedure të mirë rregulluar ligjërisht dhe transparente. Kriteret e çdo pozicioni pune janë ligjore, të mirëpërcaktuara dhe në funksion të fushës së veprimtarisë të Sektorit të Shërbimit Social.

II. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë e Sektorit të Shërbimit Social

Sektorit i Shërbimit Social ka për mision organizimin dhe monitorimin e punës rehabilituese dhe ri-integruese për të burgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. Detyrat kryesore të sektorit janë:

1. Planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli i punës rehabilituese dhe ri-integruese për të burgosurit.
2. Zbatimi i legjislacionin në fuqi dhe zërthimi i tij në terma të përcaktimit të drejtimeve kryesore të punës rehabilituese dhe ri-integruese me të burgosurit.
3. Identifikimi i aktiviteteve në përmbushje të objektivave të punës rehabilituese dhe ri-integruese për të burgosurit;
4. Planifikimi i burimeve të nevojshme në përmbushje të punës rehabilituese dhe ri-integruese për të burgosurit;
5. Kontrolli sistematik i realizimit të aktiviteteve dhe efikasitetit të përdorimit të burimeve në dispozicion;
6. Kontrolli mbi produktet e punës rehabilituese dhe ri-integruese për të burgosurit dhe vlerësimi i rezultateve.

IV. Përgjegjësitë Kryesore

a) Planifikimi dhe Objektivat

Planifikimi i objektivave vjetorë të shërbimit social në sistemin e burgjeve.

b) Menaxhimi

Organizimi, kontrolli dhe koordinimi i masave në funksion të procesit rehabilitues dhe ri-integrues të të burgosurve në IEVP; Inspektimi për të kontrolluar zbatimin e praktikave të miratuara të dokumentimit të punës të sektorit të shërbimit social në IEVP; Disiplina në punë dhe zbatimi i kodit të etikës dhe komunikimit.

c) Detyrat teknike

Hartimi i programeve rehabilituese dhe përgatitja e formateve tip të planeve individuale të rehabilitimit dhe riintegritimit që zbatohen nga IEVP-të në bashkëpunim me institucionet kompetente; Propozimi dhe hartimi i akteve administrative për përmirësimin të praktikave të punës së sektorëve të shërbimit të shërbimit social në IEVP; Bashkëpunimi me Sektorin e Trajnimeve për vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e trajnimit të stafëve në varësi; Organizimin e seminareve, tryeza pune dhe diskutimi, me qëllim përmirësimin e praktikave të punës dhe rritjen profesionale të stafëve në varësi; Raportimi periodik tek eprorët (sipas hierarkisë) mbi zbatimin objektivave të punës së sektorit, problemet e konstatuara dhe propozimi i zgjidhjeve; Pjesëmarrja në komisione apo grupe pune të ngritura dhe kontributi sipas fushës së ekspertizës; Përmbushja e çdo urdhëri apo porosie të eprorëve të linjës, që nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

d) Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

Koordinimi i punës dhe bashkëpunimi me institucione të tjera përgjegjëse për arsimin, formimin profesional, si dhe institucione të qeverisjes vendore, me qëllim ofrimin e shërbimeve për të burgosurit, gjatë dhe pas lirimit; Bashkëpunimi me organizata/shoqata të vendit dhe të huaja, që kanë për objekt ofrimin e shërbimeve sociale, ligjore, psikologjike dhe religjioze për kategori të ndryshme të të burgosurve, duke propozuar prioritetet e bashkëpunimit, koordinuar dhe

monitoruar aktivitetin e tyre në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara me DPB; Përgatitja e raporteve dhe përfaqësimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në raportime sa lidhet me procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të të burgosurve.

V. Procesi vendimmarrës

Sektori i Shërbimit Social nuk ka karakter të drejtëpërdrejtë vendimmarrës. Specialisti përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili varet direkt nga Drejtori i Drejtorisë. Sektori merr udhëzime specifike nga Drejtori i Drejtorisë, si edhe udhëzime të përgjithshme nga Drejtori i Përgjithshëm.

VI. Vlerësimi i risqeve

Risku operacional

Struktura organizative e Sektorit të Shërbimit Social në DPB bën të mundur që në aspektin operacional sektori të përmbushë detyrat e veta funksionale. Edhe përbërja e kësaj strukture me psikologë dhe punonjës social të kualifikuar dhe të trajnuar krijon mundësi për një trajtim multidisiplinor dhe përmbushje të objektivave të punës të këtij sektori. Personel i mjaftueshëm ka krijuar mundësi edhe për të mbuluar procese të rëndësishme të punës në DPB si pjesëmarrja në grupe pune/komisione apo edhe në procese të tjera administrative të deleguara nga eprorët. Gjithsesi, mund të themi se nuk është e njëjta situatë për sektorët e varësisë në IEVP, të cilët janë të angazhuar direkt me përmbushjen e objektivave të shërbimit social në tërësi për të gjithë sistemin.

Risku operacional i sektorit në nivel DPB është i ulët, ndërsa në nivel IEVP është i lartë dhe afekton cilësinë, standardin dhe integritetin e shërbimit psiko-social.

Një aspekt tjetër që paraqet risk të mesëm është zbatimi i Kodit të Etikës nga ana e stafit të DPB. Kodi aktual është miratuar në vitin 2005, ndërkohë që nevojitet përmirësimi i tij dhe zhvillimi i sesioneve informuese për stafin që punon në DPB.

Risku financiar

Sektori i Shërbimit Social nuk ka implikime të drejtëpërdrejta për administrim apo menaxhim buxheti. Gjithsesi, sektori përfshihet në planifikime buxhetore në funksion të realizimit të programeve dhe aktiviteteve rehabilituese dhe riintegruese për të burgosurit në IEVP.

Në aspektin praktik, në buxhetin e DPB nuk ka një zë të veçantë për nevoja të përmbushjes së procesit rehabilitues e riintegruës dhe në këtë drejtim nuk ka përvoja të trashëguara qoftë edhe për të vlerësuar: si është kryer procesi i planifikimit të nevojave për këtë shërbim në burgje, sa në përputhje me nevojat është kryer planifikimi (në terma vjetore ose afatmesëm), si dhe sa janë planifikuar dhe adresuar risqet, si janë përdorur burimet financiare në përmbushje të qëllimit rehabilitues të të burgosurve, cilat kanë qenë efektet dhe sa janë përmbushur pritshmëritë, si është monitoruar procesi etj..

Në mungesë të buxhetit për shërbimin psiko-social në burgje, risku financiar paraqitet i ulët, por mungesa e tij theksojmë se çënon cilësinë, standardin dhe integritetin e shërbimit psiko-social në tërësi.

Por, edhe nëse ky buxhet do të vihej në dispozicion për nevoja të këtij shërbimi në burgje, në nivel qendror (DPB) Sektori i Shërbimit Social nuk ka njohuritë dhe trajnimet e nevojshme për metodologjitë e planifikimit financiar sipas nevojave për këtë shërbim në burgje, planifikimin dhe adresimin e riskut financiar, si monitorohet procesi i përdorimit të financave për këtë shërbim etj..

1. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN LIGJOR

Në zbatim të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023 dhe në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me urdhrin Nr. 334, datë 07.10.2020, është hartuar raporti i vlerësimit të riskut të integritetit për Sektorin Ligjor, strukturë në përbërje të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Raporti vlerësues/analiza e riskut është e përmbledhur dhe i fokusuar në problematikat dhe në aspektet kyçe që ka Sektori Ligjor, referuar pikave të renditura më poshtë:

I. Analiza e kuadrit ligjor

Legjislacioni i fushës është kryesisht i qendrueshëm. Ndryshimet ligjore nuk kanë qenë të shpeshta. Aktet e nxjerra që rregullojnë veprimtarinë e këtij sektori kanë qenë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe në ligje të tjera. Sektori Ligjor nuk është ndeshur me probleme gjatë zbatimit të legjislacionit të brendshëm. Aktet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e Sektorit Ligjor janë:


- Urdhër Nr. 43 datë 25.03.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sistemit të institucioneve në varësi të saj”.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.
- Ligji Nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”.
- Ligji Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”.
- Ligj Nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”.
- Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 437, datë 20/05/2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 1, datë 31.5.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”

Sektori Ligjor, për shkak të natyrës së punës së tij, duke qenë se si detyrë funksionale ka edhe përfaqësimin ligjor të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në proceset gjyqësore ku drejtoria është palë apo person i tretë, përdor të gjithë legjislacionin material dhe procedural në ligje dhe kode të ndryshme, në mënyrë që aktet e nxjerra si produkt i veprimtarisë dhe punës së këtij sektori si kërkesë padi, prapësime, ankime, rekurse etj., të jenë sa më të vlefshme para gjykatave, në mbrojtje të interesave të institucionit. E njëjta gjë vlen dhe për kthim përgjigjet që bëhen në trajtim të ankesave administrative.

II. Analiza e organizimit të brendshëm

Struktura organizative ka qenë e qëndrueshme dhe ndryshimet organizative të ndodhura nuk kanë prekur në thelb këtë strukturë. Me strukturën e vitit 2018, ky sektor përbëhej nga 1 (një) përgjegjës sektori dhe 3 (tre) specialistë dhe ishte e plotësuar si strukturë pa vende vakante.

Me rishikimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Brendshme, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 43, datë 25.03.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sistemit të institucioneve në varësi të saj”, ky sektor u emërtua Sektor Ligjor me 4 specialistë dhe një përgjegjës sektori në strukturë, në varësi të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Shoqërore e cila është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.



Punonjësit e këtij sektori janë nëpunës civilë, të cilët rekrutohen sipas një procedure të mirë rregulluar ligjrisht dhe kontrolluar sikurse edhe transparente. Kriteret e çdo pozicioni pune janë ligjore, të mirëpërcaktuara. Nëpunësi më i vjetër në këtë sektor, qëndron në pozicionin e specialistit prej 8 vitesh. Vlerësimi i aftësive individuale të punës bëhet në mënyrë periodike 2 herë në vit sipas legjislacionit në fuqi. Vlerësimet e punës në përgjithësi janë objektive dhe pasqyrojnë treguesit kryesor të performancës së punonjësve.

III. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Sektor Ligjor mbron interesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve përballë ankesave gjyqësore dhe administrative.

Sektor Ligjor përfaqëson interesat e institucionit në proceset gjyqësore ku Drejtoria është palë. Ndjek procedurat dhe kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të ankesave të mbërritura në Sektor, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në atë ligjor, duke bashkëpunuar edhe me strukturat e tjera në Drejtori apo me institucionet e varësisë.

Përgatit materialet shkresore të nevojshme/deklaratën e mbrojtjes në proceset gjyqësore, kërkesë paditë, prapësimet, ankimet, rekurset dhe të gjitha aktet e tjera procedurale për të garantuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të institucionit.

Përgatit përgjigjet për ankesat administrative, duke u konsultuar paraprakisht me strukturat e tjera në Drejtori që janë përgjegjëse për rastet konkrete, dhe i diskuton ato me strukturat eprore.

Mban kontakte dhe bashkëpunon me të gjitha strukturat brenda dhe jashtë Sektorit apo

Drejtorisë, si dhe me institucionet e varësisë, për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që lidhen me ankesat e qytetarëve dhe të të burgosurve.

Merr pjesë në grupe pune, si dhe kryen detyra të tjera të përfaqësimit institucional të ngarkuara nga titullari.

IV. Analiza e procesit të zinxhirit vendimmarrës

Vendimmarrja e këtij sektori është e shpeshtë dhe e vazhdueshme, por brenda një tërësie standartesh administrative dhe\ose procedurash teknike, brenda atyre të përmendura më lart. Vendimmarrja lidhet me identifikimin e alternativave për të ofruar një zgjidhje sa më të mirë të problematikave që sektori trajton. Zakonisht e standardizuar dhe deri diku komplekse, problemet e hasura kërkojnë zgjidhje mbi bazën e interpretimeve e procedurave ligjore, brenda politikave.

Sektori Ligjor nuk ka karakter të drejtpërdrejtë vendimmarrës në ofrimin e shërbimeve pasi ai nuk ofron shërbime për qytetarët. Specialisti përgjigjet para përgjegjësit të sektorit, i cili varet nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori përgjigjet direkt përpara Drejtorit të Përgjithshëm. Sektori merr udhëzime specifike nga Drejtori i Drejtorisë, si edhe udhëzime të përgjithshme nga Drejtori i Përgjithshëm.

Zbatimi i parimeve të Kodit të Etikës dhe në cënim të figurës së punonjësit, përveçse nga Drejtori i Drejtorisë, monitorohen edhe nga sektori i burimeve njerëzore.

Përsa i përket mekanizmave të kontrollit, në kuadër të llogaridhënies të strukturat eprorë, ky sektor raporton në fund të çdo procesi gjyqësor dhe në hartimin e akteve si kërkesë padi, deklaratë mbrojtjeje, prapësime, ankime, rekurse etj, konsultohet me eprorët dhe strukturat përkatëse të specializuara në fushën brenda objektit të së cilës zhvillohet konflikti.

Si i tillë, nivelin e riskut të korrupsionit mund ta konsiderojmë të ulët pasi Sektori Ligjor nuk ka procese dhe struktura potenciale apo të ndjeshme dhe të ekspozuara direkte ndaj korrupsionit. Nuk është identifikuar në të shkuarën asnjë rast korruptiv nga nëpunësit e këtij sektori.

V. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit ligjor, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

🚦 Reputacional

1. Publicitet negativ në media: Sektori Ligjor bën përfaqësimin ligjor të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në gjykata, dhe për çështje të caktura që kanë një rëndësi të veçantë në opinionin publik, në gjykim mund të jenë prezente edhe mediat. Në çdo rast, nëpunësi i këtij sektori përpiqet të bëjë një përfaqësim sa më dinjitoz, të argumentojë me prova dhe fakte qëndrimet e tij në mënyrë që të mos lërë vend për këqinterpretim të asaj që thuhet në proceset gjyqësore. Gjithashtu, në rastin e trajtimit të ankesave, qytetarët e pakënaqur nga përgjigja e kthyer, mund të bëjnë publike kthimpërgjigjet e bëra duke e interpretuar në disfavor të drejtorisë. Në çdo rast, nëpunësi i Sektorit Ligjor përpiqet të jetë sa më i saktë, i qartë dhe konçiz në aktet që nxjerr si sektor, në trajtim të ankesave që vijnë si nga të burgosurit ashtu edhe nga qytetarët e tjerë.

2. Humbje e besimit në opinionin publik: Nëpunësi i këtij sektori ka përballë në seance gjyqësore një person që në vetvete është publik, dhe për të mbrojtur interesat e institucionit, përdor të gjitha mjetet ligjore por pa abuzuar me to. Mënyra se si ndërvepron në seance dhe përdor këto mjete, krijon përshtypjen e pjesëmarrësve në gjykim për Drejtorinë e Përgjithshme pasi nëpunësi në çdo rast përfaqëson vullnetin e Drejtorisë së Përgjithshme. E njëjta gjë vlen edhe për trajtimin e ankesave administrative, pasi nëpunësi duhet të jetë i kujdesshëm në përgjigjet që kthen.

Operacional

3. Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e rëndësishme dhe trajtimin e ankesave administrative: Aktualisht në përbërje të strukturës së Sektorit Ligjor është vetëm 1 specialist, pra, janë vakant 3 (tre) pozicione si specialist dhe 1 (një) pozicion si përgjegjës sektori. Plotësimi i këtyre pozicioneve vakante po shihet me prioritet nga Sektori i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.

Financiar

4. Shpenzime gjyqësore të larta si pasojë e gjyqeve: Nga proceset gjyqësore mund të vijnë kosto të larta, prandaj nëpunësi i këtij sektori kujdeset gjithmonë që të jetë sa më efektiv në mbrojtjen e interesave të institucionit. Në veprimtaritë administrative të cilat mund të kundërshtohen në gjykatë më vonë, zakonisht merret edhe mendimi i Sektorit Ligjor.

7. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR DREJTORINË E POLICISË SË BURGJEVE

I. Kuadri Ligjor

Në zbatim të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023 dhe në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, është hartuar raporti i vlerësimit të riskut të integritetit për Sektorin e Policisë së Burgjeve, strukturë në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Raporti vlerësues/analiza e riskut është e përmbledhur, i fokusuar në problematikat dhe në aspektet kyçe që ka Sektori i Policisë - hartuar sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore të Ministrisë së Drejtësisë, si më poshtë:

II. Analiza e kuadrit ligjor

Aktet e nxjerra që rregullojnë veprimtarinë e këtij sektori kanë qenë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligje të tjera.

Sektori i Policisë nuk është ndeshur me probleme gjatë zbatimit të legjislacionit të brendshëm.

Aktet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e Sektorit të Policisë janë:

- Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”
- Ligjit Nr. 80/2020, datë 25.6.2020 “Për Policinë e Burgjeve”;
- Ligjit Nr. 81/2020 datë 25.6.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;

- Ligjit Nr.72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit" dhe VKM nr. 471, datë 06.05.2009 "Për llojet e armëve dhe përdorimin e tyre";
- Ligjit Nr 45/2019 "Për mbrojtjen civile"
- "Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve", të miratuar me VKM, Nr. 437, datë 20.05.2015;
- "Rregullores së hollësishme të sjelljes së punonjësve të policisë", të miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr. 5251/2, datë 30.07.2010;
- Marrëveshjes Nr. 2194 prot, datë 05.03.2019 të Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve dhe Nr. 897/3 prot, datë 04.03.2019 të Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Urdhërit Nr. 1277, datë 05.02.2019 "Për bashkëveprimin e Grupeve të Shoqërimit dhe Sigurisë të IEVP-ve me Drejtorinë e Policisë"
- Urdhri Nr.10642 datë 20.10.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për miratimin e procedurës "Shkrimi dhe administrimi i Raporteve të Incidentit".
- Urdhër Nr.409 prot, datë 19.07.2021 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale për Policisë e Burgjeve"
- Urdhërit Nr. 5640 prot, date 12.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm "Për identifikimin, vlerësimin dhe marrjen e masave parandaluese për arratisje"
- Urdhrit Nr.3224/1 datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë për miratimin e Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhëniet e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve"
- Urdhër Nr.43 prot, datë 25.03.2021 të Kryeministrit të Shqipërisë "*Për miratimin e strukturës organike së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sistemit të Institucioneve në vartësi të saj.*"
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 519, datë 08.09.2021 "Per miratimin e Rregullores së Disiplinës për Policinë e Burgjeve" – përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr. 4414/2 Prot., datë 08.09.2021.
- Udhëzimi Nr.4, datë 22.01.2021 i Ministrit të Drejtësisë "*Për përcaktimin e procedurave të dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta për të dënuarit*" – përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr. 408/1 dt. 25.01.2021.
- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 2622 Prot., date 05.03.2020 "*Për korrespondencën me institucionet që kanë kompetencë të mbikqyrin respektimin e kërkesave ligjore për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve*";
- Udhëzimi i Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 2623 Prot., datë 05.03.2020 "*Për administrimin e procedurave të komunikimit dhe ëe takimeve të stafit me të dënuarit/paraburgosurit*".
- Si bazë kryesore për zhvillimin e veprimtarisë saj, ku përfshihet e gjithë veprimtaria e punës fizike e punonjësve të Policisë së Burgjeve sipas Hierarkisë dhe detyrave funksionale - në shërbim të garantimit të sigurisë fizike apo dinamike, janë referencat e parashikuara në "*Rregulloren e hollësishme të sjelljes së punonjësve të policisë*", të miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr. 5251/2, datë 30.07.2010;

Spektori i Policisë, për shkak të natyrës së punës së tij dhe detyrave funksionale në funksion të garantimit të rendit e sigurisë në Institucionet e ekzekutimit të vendimeve Penale, përdor të gjithë legjislacionin material dhe procedural në ligje dhe kode të ndryshme, në mënyrë që aktet rregullative të nxjerra si produkt i veprimtarisë dhe punës së këtij sektori - të jenë sa më të vlefshme, në mbrojtje të interesave të institucionit, stafit dhe të të burgosurve, gjithashtu.

III. Analiza e organizimit të brendshëm.

Struktura organizative ka qenë e qëndrueshme dhe ndryshimet organizative të ndodhura nuk kanë prekur në thelb këtë strukturë.

Me rishikimin e strukturës dhe organikës së re⁸, kësaj Drejtorie iu shtua një sektor i Forcave Operacionale Speciale me 2 Sp/Policië të Rolit të Mesëm dhe 25 punonjës të rolit bazë në strukturë, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme.



IV. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Drejtoria e Policisë së Burgjeve në përmbushje të misionit të saj për të garantuar sigurinë, të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve, ka fokus kryesor në:

1. Rritjen e sigurisë në burgje dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet
 - intensifikimit të kontrolleve,
 - përmirësimit të procedurave dhe akteve ligjore e nënligjore,
 - Eliminimin e favorizimeve të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe anëtarë të grupeve të strukturuar kriminale.
 - Investimeve në teknologji dhe pajisje
2. Zbatimin e Regjimit të Posaçëm në seksionet e sigurisë së lartë, në zbatim nenit 17 të ligjit 81/2020 “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”
 - Hartimin e akteve nënligjore, lidhur me regjimin e posaçëm, zbatimin e procedurave, menaxhimin e situatave dhe të ankesave.
 - Studimi i të dhënave të të burgosurve që janë dënuar, ose në procedurë gjykimi për veprat penale të parashikuara nga neni 17 i ligjit 81/2020 “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”
 - Bashkëpunimi me Prokurorinë e Krimeve të Rënda
3. Përmirësimi i procedurave të rekrutimit, trajtimit dhe trajnimit të stafit
 - Bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë për zhvillimin e procedurave të rekrutimit⁹
 - Trajnimi i punonjësve të rinj lidhur me aftësitë operacionale, pajisjet dhe armët, çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm
 - Pajisjen me uniformë të punonjësve të policisë.
 - Garantimin me ligj të të drejtave të punonjësve të policisë lidhur me kushtet e trajtimit, zhvillimit të karrierës, trajnimit, unifikimit të pagës për gradë dhe trajtimin për vështirësi dhe vjetërsi pune, mbrojtje të veçantë, etj.

⁸ sipas urdhrorit të Kryeministrit Nr. 43, datë 25.03.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sistemit të institucioneve në varësi të saj”

⁹ testimi dhe përzgjedhjes

- Pezullimin e transferimeve pa kriter në distanca të konsiderueshme dhe rikthimin e punonjësve të transferuar brenda territorit të vendbanimit.
- 4. Bashkëpunim ndërinstytucional dhe me partnerë ndërkombëtarë për forcimin e sigurisë publike, shkëmbim informacioni dhe realizimin e programeve rehabilituese dhe trajnuese.
 - Përmirësim i të gjithë treguesve të sigurisë, që lidhen me arratisjet, tentativat për arratisje, mbajtje të sendeve të ndaluara, konflikte, humbje jete, etj.,
 - Respektimin e kodit të etikës në marrëdhëniet e punës me kolegët dhe eprorët.

V. Në rrafshin operacional

Në kuadrin operacional, Drejtoria e Policisë është fokusuar në disa faktorë të cilët janë potencial rrisht i lartë –faktorë me ndikim negativ që lidhen direkt me integritetin e secilit punonjës policie, ku ndër më prioritetet parashtrajmë si më poshtë:

- Garantimi i masave të sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të p/burgosurve e të dënuarve nga një institucion në një tjetër.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë gjatë shoqërimit të p/burgosurve e të dënuarve për zhvillimin e seancave gjyqësore.
- Garantimi i sigurisë gjatë zhvillimit të veprimtarive artistiko-kulturore me të p/burgosur e të dënuar në institucione.
- Sigurimi dhe ruajtja e të p/burgosurve e të dënuarve në spitale civile, private apo publike.
- Sigurimin e jetës e shëndetit e të p/burgosurve e të dënuarve dhe punonjësve në rastet e jashtëzakonshme apo fatkeqësive natyrore.
- Realizimi i kontroleve për sende të ndaluara në regjimet e brendshme e të jashtme në të gjitha I.E.V. Penale.
- Realizimi i seancave gjyqësore në institucionin e Gjykatave
- Ruajtja fizike e objekteve e institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
- Trajtimi dhe aftësimi profesional i punonjësve të Policisë së Burgjeve, për njohjen e kuadrit ligjor dhe akteve të reja normative, për kryerjen e detyrës me etikë dhe përkushtim.

VI. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit Policor, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit konsistojnë në:

Faktorë operacionalë:

- Shkelje e rregullave të shërbimit nga punonjësit e stafit të burgjeve
- Mosmenaxhim dhe drejtim jo i mirë nga niveli i lartë i drejtimit
- Mos zbatim i urdhrave dhe udhëzimeve që lidhen me kontrollin dhe sigurinë
- Dhënia e së drejtës së takimeve me familjarët jasht parametrave/ambienteve të parashikuara - pra duke lejuar takimet ne ambiente të pambikqyrura¹⁰
- Lejimi i takimeve me persona jasht familjes apo më shumë persona sesa janë përcaktuar në rregullore.

¹⁰ dhoma këshillimi apo prindërimi, avokat etj..

- Lejimi i futjes së ushqimeve në regjimin e brendshëm, në kundërshtim me rregullat për peshën/sasinë dhe llojin e produkteve ushqimore të cilat nuk lejohen për konsum¹¹
- Kontrolli jo i duhur i pajisjeve elektroshtëpiake apo enëve të guzhinës¹²
- Mungesa e pajisjeve të kontrollit dhe observimit

8. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E ARKIV - PROTOKOLLIT

Sektori i Arkiv-Protokollit ka për mision të mbështesë punën e sektorëve funksionalë nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të punës së Sektorit të Protokollit me të gjithë sektorët e tjerë të DPB-së, duke punuar me standard të lartë integriteti profesional, transparent dhe etik në zbatim të ligjit dhe rregullave për të përmbushur misionin parësor të të gjithë Sistemit të Burgjeve dhe objektivave të përgjithshëm të tij. Realizimi i këtij misioni synon të japë siguri objektive për vijueshmërinë e një aktiviteti normal të sistemit, duke përmbushur njëkohësisht edhe të gjitha objektivat e sektorit. Ky harmonizim plotësohet me administrim eficient të dokumentacionit sipas ligjit dhe rregullores, si dhe shpërndarje të menjëhershme të tij.

I. Realizimi i tre objektivave themelore

Realizimi i tre objektivave themelore të sistemit të burgjeve mbështetet edhe nga kontributet e punës së Sektorit të Protokoll-Arkivit, nëpërmjet arritjes së objektivave specifike të mëposhtme:

- ✚ Administrimi i sigurtë i postës sekrete dhe informacionit të klasifikuar.
- ✚ Zbatimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për ruajtjen e sigurisë, integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit të protokolluar dhe arshivuar.
- ✚ Shpërndarja e menjëhershme dhe brenda të gjitha afateve e të gjithë dokumentacionit të postës së thjeshtë dhe sekrete, si brenda DPB-së ashtu edhe në të gjitha institucionet.
- ✚ Administrimi i sigurtë i dokumentacionit shkresor të ardhur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe arkivimi i tij.

II. Kuadri Ligjor:

- Ligji Nr.9154 dt.06.11.2003 “Per arkivat”
- Ligji Nr.8457 dt.11.02.199 “Per informacionin e klasifikuar “Sekret Shteteror” (i ndryshuar)
- VKM Nr.263 dt.12.05.2021
- VKM Nr.189 dt.04.03.2015
- Urdhra, udhëzime etj..

III. Rrjedha e punës në Sektorin e Arkivës

- Puna e Sektorit të Arkivës kryhet në bazë të Ligjit për Arkivat Nr. 9154, datë 06.11.2003.
- Marrja e dokumentave bëhet në bazë të një procesverbali i cili është i firmosur nga të dy personat, marrësi në dorëzim dhe dorëzuesi. Procesverbali përmban numrin e dokumentit, përshkrimin dhe numrin e fletëve të dorëzuara.

¹¹ kontrollorët

¹² komisioni i blerjes dhe kontrollit

- Bëhet përpunimi tekniko-shkencor i dosjeve.
- Organizimi i punës për shfrytëzimin e dokumentave për plotesimin e kërkesave operative duke hartuar për këtë qëllim mjete të ndryshme informative.
- Dalja e shkresave nga arkivi i institucionit (fotokopje e origjinalit, e njehsuar me vulën e vogël të institucionit) bëhet në bazë të Urdhërit Nr.57, datë 10.02.2014.
- Dalja e shkresave për të gjitha Drejtoritë/Sektoret e Institucionit bëhet në bazë të një memo-je sqaruese, ku kërkohet arsyeja dhe përdorimi i informacionit.
- Dalja e shkresave nga institucioni për kërkesa të ndryshme që vijnë nga Gjykata, Prokuroritë, Interpoli dhe institucione të tjera,
- Përpilimi, shtypja, shumëfishimi i dokumenteve, brenda mjediseve zyrtare të institucionit.
- Marrja e dosjeve të tenderave nga Sektori i Prokurimeve, në baze të procesverbalit ku listohen të gjitha shkresat që ndodhen në praktikën e tenderimit. Procesverbali është i firmosur nga të dy personat, marrësi në dorëzim dhe dorëzuesi.
- Vendosja e dosjeve që vijnë nga Sektori i Protokollit për në Arkivë, ndarja në rafta sipas vitit dhe sektorëve.
- Vendosja e dosjeve nëpër dollape dhe rafta, duke etiketuar vitin e dosjeve të sektorëve të ndryshëm, dhe duke përpiluar për secilin raft apo dollap një inventar për përmbajtjen e të gjitha dosjeve.
- Marrja në dorëzim edhe e ditareve të protokollit, të sekretuara në bazë të numrit të fletëve dhe numrit të dokumenteve.
- Dokumentat e marra në arkivë, regjistrohen në Librin e Arkivës me numrin e dosjes, emërtimin dhe në përputhje me procesverbalin e dosjes.
- Marrja në dorëzim e librave të protokollit pasi sekretohen me vulë në fund të librit dhe me numrin e dokumentave të protokolluara.
- Bashkërendimi i punës me Sektorin e Protokollit duke marrë pjesë në mbylljen e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese.
- Të gjitha dokumentat e dixhitalizuara, arkivohen çdo vit në CD, dhe ruhen në kasafortën e Arkivës së D.P. Burgjeve.
- Përgjigjja e disa shkresave në rrugë elektronike nëpërmjet email-it zyrtar, për përdorim të brendshëm.

IV. Faktorët e riskut

Identifikimi i faktorëve të riskut që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit të Arkiv - Protokollit, si dhe impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund të konsiderojmë,

🚦 Operacionalë

- Mungesë informacioni në zbatim të akteve ligjore
- Humbje - dëmtim i dokumentacionit
- Favorizim i subjekteve apo individëve
- Shkatërrim dokumentacioni si rezultat i faktorëve të jashtëm si dhe mungesës së infrastrukturës së duhur në zbatim të plotë të standarteve në fuqi që normojnë veprimtarinë e këtij sektori.

MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Monitorimi është periodik (çdo 6 muaj) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Koordinatori është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimeve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

PLANI I VEPRIMIT, 2022-2024

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E AUDITIT TË BRENDSHËM

Objektivi: Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Sektori i auditit operon në kapacitet të plotë duke ndihmuar njësinë publike lidhur me menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë.	Kontroll i brendshëm i fuqizuar	6 mujori i 1-rë i 2022	Sektori i Burimeve Njerëzore	I lartë	Kapacitete teknike të kufizuara në garantimin e kontrolleve të brendshëm. Mungesë e burimeve njerëzore, mungesë infrastrukture, etj.	Alokimi i burimeve njerëzore, adresimi i vakancave në kuadër të zbatimit të urdhrit të kryeministrit Nr.43, datë 25.3.2021	Sektori i Burimeve Njerëzore DAP
Kryerja e procedurave të kontrollit të brendshëm në përputhje të plotë me statusin organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e njësisë.	Akti administrative rregullues “Karta e Auditimit” në DPB	6 mujori i 1-rë i 2022	Auditi i Brendshëm	I lartë	Dobësi organizacionale dhe menaxheriale sa lidhet me proceset e auditimit në institucion	Hartimi dhe miratimi me i “Kartës së Auditimit” mbi statusin organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm	AB
Fuqizimi i njësisë përgjegjëse e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni	Stafe të trajnuar për zbatimin e ligjit dhe proc. të hetimit dhe shqyrt të sinjalizimeve dhe praktikave të dyshuara korrup. nga ana e staf të DPB	2022	Njësia e Sinjalizimit	I lartë	Mos klasifikim i saktë të rasteve të sinjalizimit, nga sinjalizuesit sipas përcaktimeve të ligjit përkaëts	Trajnimi dhe mbrojtja e burimeve njerëzore pranë njësisë së sinjalizimit	Njësia e Sinjalizimit

Stafi në DPB ushtron funksionet respektive me qartësi, efikasitet dhe konfirdencë të plotë	Miratimi i një nënakti rregullues “Rregullore e Brendshme e Drjtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”	2022	Drejtoria e Cështjeve Ligjore dhe Shoqërore	I lartë	Konfuzion në lidhje me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e programit dhe veprimtarisë operacionale të DPB.	Miratimi i nënaktit rregullues	Drejtoria e Cështjeve Ligjore dhe Shoqërore MD
Menaxhim programatik dhe operacional me efikasitet të lartë	Miratimi i një akti strategjik që lehtëson ndërveprimin, raklordimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial	6M2 2022	Drejtoria e Cështjeve Ligjore dhe Shoqërore	I mesëm	Mundësi për mungesë të efektivitet në komunikimin administrativ ndërmjet sektorëve	Miratimi i “Hartës së Proceseve të Punës” në sistem	Grupi i ndërsektorial i punës Drejtoria e Cështjeve Ligjore dhe Shoqërore
Përcaktimi i objektivave strategjikë që vizionojnë veprimtarinë e institucionit	Miratimi i një nënakti strategjik “Planit Vjetor 2022”	6M1 2022	Të gjitha drejtoritë në DPB	I lartë	Mundësi për performancë të ulët në realizimin e objektivave dhe mos maksimalizim i burimeve njerëzore të institucionit.	Hartimi dhe miratimi i Planit Vjetor - 2022 të Veprimit të DPB	Të gjithë drejtoritë
Zbatimi i rregulloreve të brendshme të posaçme për proc. e shqyrt. të hetimit administrativ të sinjal dhe meke mbrojtjes së konfidencialitetit.	Rritja e efijencës e shqyrtimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimit	Periodik 2022	AB	I Mesëm	Procese jo adekuate të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimit	Trajnimi dhe fuqizimi i stafit të AB në lidhje me proceset adekuate të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimit	Njësia e Sinjalizimit

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN FINANCË / BUXHET

Qëllimi: Administrimi financiar për përdorimin me efikasitet, kursim e dobishmëri të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të burgjeve të shprehura në buxhetin e përcaktuar

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Realizimi i objektivave parësore të sistemit të burgjeve dhe objektivave specifike të sektorit të financës/buxhetit	Raporte financiare, mujore/ Vjetore	Gjatë vitit ushtrimor 2022	Sektori i Financës dhe Buxhetit	I mesëm	Menaxhimi i i raportimeve financiare jo në kohë dhe joefikasitet mund të rezultojnë në mundësi për rreziqe të veprimeve financiare (krijimi i detyrimeve, krijimi i moslikuiditetit për shërbime #)	Ndjekja hap pas hapi e ecurisë për realizimin e buxhetit të miratur, realizimit të shpenzimeve faktike për çdo natyrë të vecantë shpenzimi, si dhe monitorimi i fondeve buxhetore vjetore.	Sektori Financës/ Buxheti
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit buxhetor afatmesëm	Miratimi i PBA-së	2022	Sektori i Financës / Buxhetit	I lartë	Mosrealizimi i funksionit dhe qëllimeve të njëjësive shpenzuese në aktivitetin e tyre	Pjesëmarrja dhe trajnimi i të gjithë aktorëve, njëjësive shpenzuese në rang sistemi, sa lidhet me formulimin e kërkesave buxhetore, sipas nevojave, për çdo shpenzim buxhetor public, duke promovuar në këtë formë transparencë e efikasitet në zbatim	Grupi i GSM/ Sektori Financës / Buxhetit
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor të institucionit	Buxhet vjetor i miratuar	3 MI 2022	Sektori i Financës e Buxhetit /Sektori mbështetës	I lartë	Ndarja e buxhetit jo në përputhje të plotë të kërkesave reale çon në mosrealizimin e nevojave jetike të njëjësive shpenzuese që ka sistemi i burgjeve	Planifikimi i saktë/korrekt i buxhetit të miratuar me ligj pasi promovon parandalimin e përdorimit të fondeve me efektivitet	NA/NZ/Gjithë sektorët e tjerë

Hartimi i listë - pagesave mujore për punonjësit e njësisë shpenzuese	Listë pagesa mujore të finalizuara	Çdo muaj	Financa/ Buxheti	I mesëm	Zyrtarët mund bëjnë modifikime të paautorizuara në bazën e të dhënave të listës së pagave për përfitime personale. Zyrtarët mund deklarojnë detaje të pasakta të dhënash në përpunimin e listës së pagave. Si rezultat, pagat mund t'iu paguhen punonjësve fiktivisht.	Sigurimi I tërë praktikës dokumentare justifikuese që vërteton listë - pagesat e parashtruara nga sektori i burimeve njerëzore	Burime njerëzore Financë / Buxhet
Finalizimi i likuiditetit të cdo shërbimi të kontraktuar për sektor	Likuiditeti për cdo shërbim	Gjatë vitit për cdo projekt	Financa/ buxheti	I mesëm	Zyrtarët mund të japin informacion të rremë për rimbursimin e shpenzimeve, të bëjnë kërkesa për rimbursim bazuar në fatura të pavërteta. Verifikimi jo i duhur i faturave çon në tepricë pagesash.	Sigurimi I tërë praktikës dokumentare justifikues që vërteton shpenzimet e pretenduara për likuiditet	Financa /buxheti Sektorët mbështetqë monitorojn ë kontratat
Azhornimi me kuadrin e ri ligjor, me teknologjinë (metoda dhe sisteme të reja) për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave financiar	Stafe të fuqizuar	2022 e në vijim	Financa/ Buxheti	I mesëm	Kompleksiteti i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit	Trajnimi i stafit. Implementimi i sistemeve pilot dhe komunikim me hartues të programeve	Spektori IT Sektori Finances

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E PROKURIMEVE

Qëllimi: Forcimi i integritetit në sistemin e prokurimeve

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Zhvillimi i procedurave të prokurimit për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të sistemit	Kontraktimi për furnizimin me mallra, pune, shërbime	Gjatë gjithë vitit ushtrimor	Spektori i prokurimeve, Njësia e prokurimit, KVO, strukturat e tjera teknike	i lartë	Favorizim i një subjekti në procedurat e prokurimit, ulje i transparencës dhe shmangia e konkurrencës si rezultat i mungesës së mekanizmave të kontrollit periodik duke mos siguruar integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik	Forcimi i sistemit të brendshëm të auditimit.	Njësia e Sinjalizimit dhe Auditi i Brendshëm
Sigurimi i të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitja e regjistrimit të parashikimit dhe regjistrimit të realizimit të procedurave të prokurimit publik	Miratimi i regjistrimit nga APP	6M 1 2022	Spektori i prokurimeve	i mesëm	Mos kryerja në kohë e regjistrimit shkakton vonesa në zhvillimin e procedurave të prokurimit me pasojë mosplotësimin në kohë të nevojave të institucionit për mallra dhe shërbime	Transparenca e hapave të njëpasnjëshëm përmes koordinimit të strukturave të DPB	Struktura në DPB
Sek. i Prokurimit ndjek proc e prok. dhe kujdeset për mbarëvajtjen e proc në tërësi dhe të ankesave të OE të mbërritura në aspektin administrativ e atë ligjor, në bashkëpunim me sek. e tjerë	Administrim i saktë i proceseve dhe kthim përgjigje në kohë	Gjatë gjithë vitit	Spektori i prokurimeve + Komisioni i Shqyrtimit të ankesave	i lartë	Vonesa në finalizimin e procedurës që përkehet në vonesë të lëvrimit të shërbimeve dhe mallrave të kontraktuara për të adresuar nevojat e institucionit.	Forcimi i kapaciteteve dhe kualifikimi asetëve njerëzore në kuadër të trajtimit dhe kthimit të përgjigje në kohë ndaj ankesave	KSHA

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT SA LIDHET ME TRANSPARENCËN

Qëllimi: Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies me publikun

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Caktimi i koordinorit për të drejtën e informimit dhe miratimi i detyrave, përgjegjësi dhe ndërveprimet me strukturat e tjera të institucionit	Institucioni cakton një koordinator kompetencat e të cilit janë të parashikuara në ligjin nr 119/2014.	6M 1 2022	Autoriteti Publik	I Lartë	Mos zbatim i detyrimit për caktimin e një koordinatori.	Bashkërendim i punës mes sektorëve dhe koordinorit si rol lehtësues.	Sektorët përgjegjës sipas kategorive të informacionit të kërkuar
Miratimi, publikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës	Programi i Transparencës i miratuar dhe i publikuar në ëëbin zyrtar të DPB	Sipas afatit të përcaktuar nga KDI	Struktura përgjegjëse për transparencën	Të publikohet brenda afatit	Mos zbatimi i afatit të përcaktuar nga KDI	Bashkërendimi i punës mes sektorëve dhe koordinorit si rol lehtësues.	Sektorët përgjegjës sipas kategorive të informacionit të kërkuar.
Hartimi, miratimi dhe publi i raportit vjetor në Prog e Transparencës.	Raport Periodik i publikuar në faqen zyrtare	Periodik	Struktura përgjegjës për transparencën	I mesëm	Mungesë e informimit të publikut mbi veprim. e instit.	Informimi periodik i publikut mbi të gjitha aktiv	Burime të brendshme institucionale
Publikimi i rregullores e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, si dhe Rregullores për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje nga hakmarrja	Akt rregullativ i publikuar	6 M 1 2022	Struktura përgjegjëse për transparencën	I mesëm	Mundësi për dekurajim të punonjësve për të sinjalizuar rastet korruptive	Informimi i publikut mbi aktet rregullative sa lidhet me procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, si dhe Rregullores për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje nga hakmarrja	Struktura përgjegjëse për transparencë Njësia e Sinjalizimit në DPB

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE

Objektivi: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Ngritja e kapaciteteve profesionale për të garantuar standartet e sigurisë dhe rehabilitimit	Punonjës të trajnuar	2022	Burimet njerëzore Qendra e Trajnimeve	I mesëm	Mos realizim të numrit të trajnimeve të planifikuara Per shkak të pandemisë	Folloë up i trajnimeve përmes platformave online	Burimet njerëzore Drejtoria e Administratës Publike Qendra e Trajnimeve
Plotësimi i vakancave në organikën e institucionit	Strukturë me kapacitet të plotë	6M 1 2022	Sektori i Burimeve njerëzore	I lartë	Mbingarkesë në përbushjen e detyrave nga funksionale nga punonjësit dhe mundësi për performancë të ulët të institucionit	Emërimi i punonjësve në vendet vakante	Burimet njerëzore Drejtoria e Administratës Publike
Stafet kryejnë detyra që nuk lidhet me detyrën e tyre funksionale	Punonjës të motivuar	6M 2 2022	Sektori i Burimeve njerëzore	I lartë	Mungesë efëçence Konfuzion rolesh Mungesë motivimi	Emërimi i punonjësve në vendet vakante Përshkrime të qarta pune	Sektori i Burimeve njerëzore Ekspertë psikologë organizativë të jashtëm

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN SOCIAL

Qëllimi: Organizimi dhe monitorimi i procesit të rehabilitimit dhe riintegrimit të të burgosurve

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struk përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Zhvillimi i infrastrukturës së duhur programatike në institucion, me në fokus rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve	Aktivitet të zhvilluara	2023	Spektori i Çështjeve Shoqërore	I mesëm	Moszbatimi i Programeve Rehabilituese	Zhvillimi i trajnimeve online (në kushtet e pandemisë) Vizita në terren me qëllim mbështetjen e stafit dhe inspektimit Projekti i KiE për fuqizimin e punës rehabilituese me të burgosurit	Spektori i Çështjeve Shoqërore KiE,
Bashkëpunimi DPB - MD - MMSR (sot MEF) për formimin profesional dhe arsimin në burgje	Marrëveshje bashkëpunimi	6M parë i 2022	Spektori i Çështjeve Shoqërore	I lartë	Mungesë mbështetje nga Institucionet/ partnerët përkatëse për zbatimin e formimit profesional, punësimit dhe arsimimit të të burgosurve	Rishikimi i marrëveshjeve të përbashkë sipas specifikave të problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të tyre; Hartimi i prot. të përbashkëta të punës për riintegrimin e rasteve; Organizimi periodikisht të takimeve të përbashkëta të punës për ndërgjegjësimin e inst. mbështetëse për këtë komponent	Spektori i Çështjeve Shoqërore MD MEF

Bashkëpunimin me Bashkitë në kuadër të riintegrimi pas lirit të të dënuarve	Plane të qarta prag liri	Çdo 6 muaj	Sektori i Çështjeve Shoqërore	I lartë	Mungesë mbështetje nga Institucionet përkatëse për riintegrimin e të burgosurve	Organizimi i takimeve të përbashkëta të punës për ndërgjegjësimin e institucioneve mbështetëse për këtë komponent Marrëveshje me OJF-të për mbështetjen dhe lehtësimin e koordinimit ndërinstytucional Hartimi i protokollove të përbashkëta të punës për riintegrimin e rasteve	Sektori i Çështjeve Shoqërore Bashkitë OJF
Monitorimi i procedurave dhe kritereve të të vlerësimit të sjelljes të burgosurve, për të ulur riskun e vlerësimeve subjektive	Raporte monitorimi	Periodik	Sektori i Çështjeve Shoqërore	I lartë	Favorizim i të burgosurve përmes vlerësimeve subjektive, si rezultat i mungesës së mekanizmave të kontrollit periodik	Forcimi i sistemit të brendshëm të monitorimit	Sektori i Çështjeve Shoqërore
Hartimi i protokolleve të qarta për procedurat dhe kriteret e punësimit të të burgosurve	Protokolle të miratuara	Mars 2022	Sektori i Çështjeve Shoqërore	I lartë	Favorizim i të burgosurve përmes punësimit subjektiv, si rezultat i mungesës së procedurave dhe kritereve të qarta	Forcimi i transparencës dhe përmirësimi i procedurave të brendshme për punësimin e të burgosurve	Sektori i Çështjeve Shoqërore

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN LIGJOR

Qëllimi: Procese ligjore me integritet

Risku/sjellja me rezik	Propabiliteti I riskut (Gjasat që risku të ndodhi: 1 i ulët deri në 10 i lartë)	Impakti I riskut (Pasojat) të ndodhur: 1 I ulët - në 10 I lartë)	Intensiteti/ Niveli I riskut (prob * impakti)	Përgjegjësit kryesorë për zbatimin e masave (personi/struktura)	Struktura të tjera mbshtetëse	Masat dhe aktivitetet për të zvogëluar/parandaluar/ trajtuar riskun	Treguesit (për të monitoruar dhe vlerësuar masat)	Objekti I treguesëve 2022
Marrje ryshfeti	2	9	18	Strukturat eprore		Kontroll i vazhdueshëm mbi veprimtarinë e sektorit.	Përcaktimi i metodave të hetimit	Ulja e rasteve të identifikuara
						Kontroll mbi deklaratimet e pasurisë kur ka dyshime	Rritja e hetimeve të brendshme	

Marrje e dhuratave, shërbimeve për të mundësuar situatë më të favorshme ose lehtësira në gjyq	2	9	18	Strukturat eprore	Burimet Njerëzore	Kontroll i vazhdueshëm mbi veprimtarinë e sektorit.	Përcaktimi i metodave të hetimit	Ulja e rasteve të identifikuar
						Kontroll mbi deklaratimet e pasurisë kur ka dyshime	Rritja e hetimeve të brendshme	
Krijim, falsifikim, ose plotësim i provave dhe dokumentave.	1	5	5	Strukturat eprore	Auditi	Kontroll i vazhdueshëm mbi hartimin e akteve dhe përmbajtjes së dosjeve gjyqësore	Përcaktimi i rregullave për hartimin e dokumentave	Ulja e rasteve të identifikuar
Ushtrim i presionit qytetarëve në seancat gjyqësore apo në takime për çështje të caktuara	2	3	6	Strukturat eprore		Trajnime të vazhdueshme mbi sjelljet me qytetarët	Plotësimi i anketimeve nga qytetarët	Rritje e kënaqësisë së qytetarëve ndaj institucionit
Publicitet negativ në media	4	6	24	Strukturat eprore		Trajnime mbi të folurën në gjykata si dhe me qytetarët	Opinionet publike mbi institucionin	Krijimi i një opinioni të mirë për institucionin
Humbje e besimit në opinionin publik	3	7	21	Strukturat eprore		Trajnime mbi sjelljen me profesionalizëm		Rritje e

							Plotësimi i anketimeve nga qytetarët	besimi t të qytetarëve te institucioni
Lëshim i informatave konfidenciale te personat e paautorizuar	4	8	32	Strukturat eprore	Oficeri i i sigurisë së DSIK	Trajnime mbi përdorimin e informacionit të klasifikuar	Ngritja e strukturave të posaçme për trajnimin	Trajnim i të gjithë punonjëseve
						Pajisja dhe njohja me kushtet e certifikatës së sigurisë		
Pranim i pijeve, ushqimeve, shërbimeve pa pagesë gjatë orarit të punës.	5	2	10	Strukturat eprore		Trajnime mbi ligjin për dhuratat	Përcaktimi i metodave të verifikimit të këtyre rasteve	Ulja e rasteve te identifikuar
Komunikimi me qytetarët ose kolegët me sjellje të keqe, pa treguar shenja respekti ose në mënyrë frikësuese	4	5	20	Strukturat eprore	Burimet Njerëzore	Trajnime të vazhdueshme mbi sjelljet me qytetarët	Plotësimi i anketimeve nga qytetarët dhe kolegët	Përmi rësimi i sjelljes me qytetarët dhe kolegët

Ofrim i ndihmës duke u bazuar në lidhjet personale.	5	6	30	Strukturat eprorë		Kontroll i vazhdueshëm i veprimtarisë nga strukturat eprorë	Përcaktimi i metodave të hetimit	Ulja e rasteve të identifikuar
							Rritja e hetimeve të brendshme	
Puna private jashtë që bën ndesh me detyrimet e punës	6	6	36	Strukturat eprorë		Kontroll i vazhdueshëm i veprimtarisë nga strukturat eprorë	Përcaktimi i metodave të hetimit	Ulja e rasteve të identifikuar
							Vlerësime të vazhdueshme të rezultateve në punë	
Papërgjegjshmëri/vonesa pa arsye në ekzekutimin e detyrimeve	4	8	32	Strukturat eprorë	Auditi	Kontroll i vazhdueshëm i veprimtarisë nga strukturat eprorë	Shpenzimet e larta si pasojë e ekzekutimit me vonesë	Riallokimi i fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore
	2	3	6	Strukturat eprorë	Spektori i shërbimeve	Nevoja për lëshimin e autorizimeve për lëvizje si	Përcaktimi i metodave dhe	Ulja e rasteve

Përdorimi i makinave zyrtare ose pajisjeve të tjera për qëllime personale					dhe Projekteve	dhe në cdo rast kërkesa për furnizim me pajisje zyre miratohet nga eprorët	rregullave të përdorimit të pronës së institucionit	e te identifikuara
Shpenzime gjyqësore të larta si pasojë e gjyqeve	4	7	28	Strukturat eprorë	Auditi	Raportimi i rregullt të strukturat eprorë mbi ecurinë e gjyqeve	Kostot nga proceset gjyqësore	Vlerësimi i vazhdueshëm i punonjësit
						Kujdes në rekrutimin e personelit në mënyrë që të punësohen persona të përgjegjshëm		Ushtrimi i kontrollit të vazhdueshëm mbi hartimin e akteve
Vendimmarrje e vesuar në trajtimin e ankesave administrative	3	7	21	Strukturat eprorë	Auditi	Vendimmarrja në çdo rast miratohet nga strukturat eprorë	Krijimi i grupeve të punës dhe moslënien e vendimmarrjen në dorën e një personi	Ulja e rasteve të identifikuara

Sipas një mesatareje aritmetike të Intensitetit/Nivelit të riskut (propabiliteti * impakti), rezulton një mesatare prej 20.46. Referuar matricës së intensitetit të rrezikut, Sektorin Ligjor mund ta konsiderojmë me "Rrezik me intesitet të moderuar" – shkeljet e integritetit në këtë proces janë të mundshme, por rreziku menaxhohet përmes masave të kontrollit.

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR DREJTORINË E POLICISË

Qëllimi: Forcimi i mekanizmave të brendshëm në kuadër të rendit dhe sigurisë

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Sistemimi i të burgosurve në dhomat e banimit	Të burgosur të akomoduar në dhoma sipas procedurave në fuqi	Në vijim	Sektori i Policisë	I lartë	Trajtim preferencial për të burgosurit (akomodimi në dhoma teke, etj.)	Sistemimi i të burgosurve duhet të bëhet bazuar në mungesë konfliktesh, ndikime negative të ndërsjellta, etj. Për këtë qëllim përdoren kriteret e tilla si: grupmosha, lloji i veprës penale, veçori sociale – ekonomike të të burgosurve dhe për aq sa është e mundur edhe kërkesat e të burgosurve	Sektori i Policisë Sektori i Çështjeve Shoqërore
Punonjësit kryejnë detyrën e	Klimë e sigurtë institucionale	Në vijim	Sektori i Policisë	I lartë	Lëvizje të shpeshta të punonjësve dhe caktimi	Respektimi me korrektesë i kriterëve që lidhen me gradën / funksionin, disiplinën,	Sektori i Policisë

tyre / shërbimin sipas skemës së sigurisë					në pozicione shërbimi, pa kriter afekton stafin dhe cilësinë e punës / shërbimit	eksperiencën, profesionalizmin dhe vlerësimin objektiv të performacës në punë	
Planizimi i turneve të shërbimit	Plan i miratuar sipas skemës së sigurisë	Në vijueshmëri	Sektori i Policisë	I lartë	Favorizim i punonjësve të caktuar Caktimi i tyre vetëm në një turn për shërbim/ shpërndarje e pabarabartë e ngarkesës së punës sipas parashik ligj	Kontrolle të vazhdueshme bazuar në procedurat ligjore në fuqi Kontroll i praktikës dokumentare Mbikqyrje e kontrolleve	Sektori i Policisë
Zbatimi i procedurave mbi takimet e të burgosurve	Ekzekutimi i së drejtës së të burgosurve sa lidhet me procesin e rehabilitimit dhe riintegritit etj.	Në vijim		I lartë	Zhvillimi i takimeve të të burgosurve me persona jshtë përcaktimeve ligjore	Kontrolle të vazhdueshme bazuar në procedurat ligjore në fuqi Monitorimi përmes kamerave dhe praktikës dokumentare Mbikqyrje e kontrolleve	
Zbatimi i procedurave të kontrollit	Zhvillim normal i aktiviteve në inst sa lidhet m rendin e sigurinë	Në vijim	Sektori i Policisë	I lartë	Futja dhe mbajtja e sendeve të ndaluara në institucion	Kontrolle të vazhdueshme bazuar në procedurat ligjore në fuqi Monirimi përmes kamerave Dhe praktikës dokumentare Mbikqyrje e kontrolleve	Sektori i Sigurisë Drejtori
Zbatimi i procedurave të shoqërimit	Operacione korrekte në kuadër të shoqërimit të të burgosurve	Në vijim	Sektori i Policisë	I Lartë	Arratisja Cënimi i sigurisë së stafit Cënimi I jetës dhe shëndetit të të burgosurit, etj.	Instruktimi i stafit mbi procedura e shoqërimit Pajisja me mjetet e duhura të parashikuara në procedurat respektive Zbatimi korrekt i tërë proc në fuqi Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera si gjykata, spitalet, etj.	Sektori i Sigurisë Drejtori Policia e Shtetit Gjykata etj.